Diaspora dhe Migracioni

Mirë se vini në seksionin e Diasporës dhe Migracionit të Bashkisë Dropull!

Ky seksion është krijuar për të ofruar informacion, orientim dhe mbështetje për qytetarët e Bashkisë Dropull që jetojnë jashtë vendit, për ata që planifikojnë të emigrojnë ose të rikthehen në vendlindje, si dhe për shtetasit e huaj që zgjedhin Dropullin për të jetuar, punuar, studiuar, investuar apo zhvilluar veprimtarinë e tyre.

Në këtë hapësirë do të gjeni informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e migrantëve dhe diasporës, mundësitë për punësim, si dhe informacion mbi programet dhe iniciativat e Bashkisë Dropull në fushën e migracionit dhe diasporës. Gjithashtu, ofrohen udhëzime dhe burime të dobishme për migracion të sigurt, të rregullt dhe të ligjshëm, procesin e rikthimit dhe riintegrimit të migrantëve, si dhe integrimin e shtetasve të huaj në komunitetin lokal.

Ky seksion është pjesë e zbatimit të **Planit Vendor për Diasporën dhe Migracionin të Bashkisë Dropull**, i cili synon të forcojë qeverisjen vendore në fushën e migracionit, të përmirësojë koordinimin institucional dhe ofrimin e shërbimeve për migrantët dhe diasporën, si dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të tyre në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Duke marrë parasysh traditën e gjatë të emigracionit të banorëve të Dropullit dhe lidhjet e forta që komunitetet jashtë vendit ruajnë me vendlindjen, Bashkia Dropull e konsideron diasporën një partner strategjik për zhvillimin lokal. Përmes këtij seksioni synohet të forcohet komunikimi dhe bashkëpunimi me diasporën, të mbështetet rikthimi dhe riintegrimi i migrantëve, të promovohet transferimi i njohurive dhe përvojës profesionale, të nxiten investimet dhe iniciativat sipërmarrëse, si dhe të ruhen e promovohen identiteti kulturor, trashëgimia historike dhe vlerat tradicionale të zonës.

Në përputhje me objektivat e Planit Vendor, Bashkia Dropull angazhohet të ndërtojë politika dhe shërbime gjithëpërfshirëse që kontribuojnë në mirëqenien e qytetarëve, fuqizimin e lidhjeve me diasporën dhe krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të komunitetit.